Klasat 1-6

Për koordinatorin:

Ju lutemi gjeni të bashkëngjitur materialin që do t'ju nevojitet për të përfunduar me sukses programin për nxënësit e Klasave 1-6. Ju lutemi shqyrtoni faqen në internet ose materialet për t'u njohur me mësimet, temën dhe planet. Do të gjeni të bashkëngjitur mes të tjerash:

1) Planin e mësimeve për çdo semestër
2) Listën e përgjithshme të materialeve të Koordinatorit për çdo mësim për t'u përgatitur paraprakisht dhe materialet/fletët për t'ju dhënë mësuesit
3) Mësimet – përfshirë informacion për t'ju dhënë mësuesve, veprimtaritë e nxënësve, përgatitjet e veprimtarive, etj. Ju lutemi siguroni se keni printuar një mësim dhe një mostër të të gjitha fletëve të veprimtarive ose udhëzimeve për mësuesin, në mënyrë që të mund të shohin se çfarë pritet të bëjnë paraprakisht dhe të bëjnë pyetje përpara ditës së mësimdhënies. Gjithashtu, sigurohuni se ose përgatisni materialet dhe ia jepni mësuesit paraprakisht ose i çoni te faqja në internet në mënyrë që të mund të printojnë materialet e tyre paraprakisht dhe të marrin ato që duhen. (Preferohet që të përgatisni materialet vetë; është më kollaj të mbani një kopje dhe që mësuesi t'ju kthejë materialet e papërdorura, në mënyrë që t'i përdorni përsëri në të ardhmen, pa u dashur të ri-krijoni disa nga veprimtaritë – si broshura e krijimit, për shembull). I mbajmë materialet e çdo semestri në kuti, në mënyrë që kur të përsërisni një semestër, thjesht merrni kutinë dhe pjesa më e madhe e punës është bërë nga hera e parë, në vend që të printoni më shumë fletë për nxënësit. Gjithashtu krijojmë një dosje 4-5 cm të mësimeve dhe fletëve për çdo semestër për mësuesit dhe këto mund të ripërdoren gjithashtu.
4) Fletët e pjesëmarrjes, fletët e këngëve dhe fletët I dashur mësues
*Ju lutemi vini re se Klasat 1-6 si grup nënkuptojnë një klasë që ka nxënës nga Klasa 1 deri tek Klasa 6. Nëse keni dhoma të klasave më të vogla dhe mund të ndani një grup në klasa më të vogla, p.sh. Klasat 1-2, mund të përdorni të njëjtin material; thjesht bëni veprimtaritë për nxënësit më të vegjël për klasat e para dhe veprimtaritë për nxënësit më të rritur për ata të klasave të tjera. Ose përdorni faqen në internet për të gjetur nivelin e çdo klase që po kërkoni.

Gjithashtu, çdo mësim përmban mbi 1 orë material dhe ndahet në segmente kohorë, kështu që sugjerojuni mësuesve tuaj që të zgjedhin veprimtaritë që preferojnë që do të sigurojnë se koha për klasët do të mbushet – duke mbajtur mend se disa herë klasat për të rriturit mund të zgjasin më shumë se koha e lejuar dhe fëmijët duhet të qëndrojnë me mësuesin.

Nëse keni ndonjë problem në gjetjen ose kuptimin e diçkaje të vendosur në faqen në internet, ju lutemi mos hezitoni të më kontaktoni në Sundayschoolbiblelessonsforkids@protonmail.com.

Ju falemnderit dhe Perëndia ju bekoftë zemrën për gatishmërinë tuaj për të shërbyer!

Me shumë dashur në Krisht,
Nadine